



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2024:063591

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05407983

CN.nr.11/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Lirika Sylaj, duke vendosur sipas propozimit të propozuesit A.M, nga fshati S., Komuna e I., tani me vendbanim në F. 10,8370 S., në shtetin e Z., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatmir Ademaj, avokat në Pejë, duke vendosur lidhur me propozimin për njohjen e Aktgjykimit të gjykatës së huaj, jashtë seancës gjyqësore me datë 04 Mars 2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET Njohja e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Toggenburg, Gjykatës Familjare – Kantoni St.Gallen, në Zvicërr, me shenjë të lëndës IN.2023.6-TO2F-TMA, i datës 25.04.2023, i plotfuqishëm dhe i zbatueshëm nga data 09.05.2023, me të cilin Aktgjykim është zgjidhur martesë në mes të propozuesit A.M nga fshati S., Komuna e Istogut tani me vendbanim në shtetin Z., F. 10,8370 S.dhe A.M nga I., tani me vendbanim në K. 6,9606 B., në shtetin e Z., e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në Komunën e I.

A r s y e t i m

Propozuesi A.M nga fshati S., Komuna e I., përmes përfaqësuesit të autorizuar, me parashtresën e datës 26.02.2021 ka parashtruar propozim për njohjen e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Toggenburg, Gjykatës Familjare – Kantoni St.Gallen në Zvicër, me numër të lëndës IN.2023.6-TO2F-TMA, i datës 25.04.2023, i plotfuqishëm nga data 09.05.2023 me të cilin Aktgjykim është zgjidhur martesë në mes të propozuesit A.M nga fshati S.Komuna e I. tani me vendbanim në shtetin e Z., F. 10,8370 S. dhe A.M nga Istogu, tani me vendbanim në K.6,9606 B. në shtetin e Z.

Propozimit i ka bashkangjitur Aktgjykimin për zgjidhje të martesës në origjinal në gjuhën gjermane, e të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesi gjyqësor Sh.Z.

Andaj, Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog, duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 të Ligjit për Gjykatat si dhe në bazë të nenit 157 lidhur me nenin 158, 159, 160 dhe 168 të NR.08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private, vërteton se janë plotësuar të gjitha kushtet për njohjen e vendimit në fjalë. Pasi që për palën kundërshtare A.M gjykata nuk ka prova se ka vendbanim

apo vendqëndrim të zakonshëm në Republikën e Kosovës dhe në këtë çështje juridike është vendosur për njohjen e vendimit të huaj sa i përket shkurorezimit të martesës, në kuptim të nenit 170 paragrafi 3 të Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private, ky vendim nuk do t'i dërgohet palës kundërshtare A.M

Nga arsyet e cekura më lartë, komfor dispozitave ligjore të lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË ISTOG
Departamenti i përgjithshëm- Divizioni për Çështje Civile
CN.nr.11//24, më datë 04 Mars 2024

Gj y q t a r j a
Lirika SYLAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, për mes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.